REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. Org. Jedin Org Unit 0113
Nr. Prot. Br. Prot Prot.No: 192
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages 1
Data: Datum: Date: 09.02.26
PRISHTINË NO.1

N.H. V.P. „IBËR-LEPENC" SH.A. D.D.
01-367 Dt. 09-02-2026
PRISHTINË-PRIŠTINA

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevardi "Bill Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: info@ iber-lepenc.org

# Raporti tre mujor, Tetor-Dhjetor 2025 TM4

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 09.02.2026 pas shqyrtimit të Raportit TM4-2025 mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në NPH "Ibër Lepenc"Sh.A, mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv: | Kryesuesi i BD: |
| Nënshkrimi | Faruk Mujka | Bajram Mustafa |
| Data: 09.02.2026 | | |

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE **"IBËR - LEPENC"** SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE **"IBËR - LEPENC"** J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE **"IBËR - LEPENC"** D.D.

Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 - Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

**Për :** Bordin e Drejtorëve

**Nga:** Faruk Mujka - Kryeshef Ekzekutiv – N.H "Ibër-Lepenc" Sh.A

**Lënda:** Raport tremujor i punës: Tetor -Nëntor -Dhjetor 2025



***Efikasiteti i përgjithshëm tremujor Tetor -Nëntor-Dhjetor 2025***

**Data: 29.01.2026**

## Përmbajtja

1. Departamenti „Uji dhe Gjenerimi" ..... 3
2. Zyra e shitjes ..... 14
3. Departamenti "Ujitja" ..... 15
4. Shërbimi i Financave ..... 18
5. Zyra e prokurimit ..... 22
6. Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ..... 28
7. Departamenti Planifikim dhe Zhvillim ..... 33
8. Njësia zbatuese e projektit WSCP ..... 37

# Aktivitetet e Njësive Afariste dhe Departamenteve

## 1. Departamenti „Uji dhe Gjenerimi"

Gjatë tremujorit të katërt (TM4), periudha Tetor-Dhjetor-2025 , në departamentin "Uji dhe Gjenerimi" është punuar intensivisht në mirëmbajtjen e kanalit kryesor për të siguruar rrjedhën e pandërprerë të ujit dhe furnizimin me ujë për konsumatorët e ndërmarrjes, kjo periodë karakterizohet me kushte hidrometeorlogjike të ndryshueshme, me prurje më të larta në muajt nëntor dhe dhjetor, ndërsa tetori ka patur prurje më të ulëta dhe nje ashtu prodhim me të ultë për shkak të ndërtimit të urave në lumin ibër. Gjithashtu, në përputhje me kërkesat e shfrytëzueseve të ujit nga sistemi i IL-it, gjatë kësaj periudhe tremujore janë shpërndarë/distribuuar gjithsej **13,874,790,** ku vlen të theksohet se NewCo Ferronikel LLC ka nga muaji dhjetor nderprer marrjen e ujit.

| TM4 | $m^3$ |
|---|---|
| KRU Mitrovicë | 4,653,370 |
| KRU Mitrovicë ( Vushtrri) | 1,748,140 |
| KUR Prishtina(Shkabaj) | 3,669,400 |
| KUR Prishtina(Drenas) | 740,914 |
| NewCo Ferronikel CoL.L.C | 156,146 |
| KOSOVA A | 124,740 |
| KOSOVA B | 2,782,080 |
| Totali | 13,874,790 |

Paraqitja grafike e sasive të distribuara të ujit në $m^3$ tetor-dhjetor 2024




| | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|
| KRU Mitrovicë | 5,769,254 | 5,347,981 | 5,763,118 | 5,020,415 | 4,653,370 |
| KRU Mitrovicë ( Vushtrri) | 1,956,541 | 1,970,875 | 2,141,294 | 1,873,509 | 1,748,140 |
| KUR Prishtina(Shkabaj) | 4,521,096 | 4,269,114 | 4,108,624 | 4,487,700 | 3,669,400 |
| KUR Prishtina(Drenas) | 1,038,056 | 1,038,381 | 897,023 | 858,024 | 740,914 |
| NewCo Ferronikel CoL.L.C | 575,294 | 400,010 | 645,977 | 440,994 | 156,146 |
| KOSOVA B | 2,318,760 | 2,782,080 | 2,782,080 | 11,160 | 2,782,080 |
| KOSOVA A | 925,931 | 1,386,180 | 254,520 | 2,782,080 | 124,740 |




Gjatë kësaj periudhe të tremujorit Tetor-Dhjetor nga HC Ujëmani janë gjeneruar **21,614.78 MWh** gjegjësisht **21,315.41 MWh** ( injektuar/plasur në sistemin transmetues, koeficienti i humbjes), apo **3% (21,000 MWh)** më shumë se planifikimi

- **Tetor:** janë gjeneruar 2,583.21 MWh, apo 63% më pak se planifikimi (7,000 MWh), si pasojë e prurjeve të vogla.
- **Nëntor:** janë gjeneruar 3,002.78 MWh(pas ndërtimit të urave është filluar të rritët prodhimi)
- **Dhjetor:** janë gjeneruar 16,028.79 MWh, që paraqet një rritje prej 129% mbi planin, si pasojë e prurjeve rapide dhe nevojës për menaxhim të hapësirës në akumulim


Diagrami i gjenerimit të energjisë elektrike për TM4 2025
18000
16000
14000
12000
10000
8000
6000
4000
2000
0
MWh
Tetor
Nentor
Dhjetor
MWh
2583.206
3,002.78
16,028.79


Krahasimi i gjenerimit nga HC ndër vitet 2016-2025
25,000.00
20,000.00
15,000.00
10,000.00
5,000.00
-
MWh
Tetor
Nentor
Dhjetor
2016
2017
2018
2019
2020
2021
2022
2023
2024
2025

| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Tetor** | 8,100.24 | 4,140.40 | 5,401.14 | 4,140.82 | 5,611 | 3,976.89 | 4,727.79 | 4531.34 | 3,013.79 | 2583.206 |
| **Nentor** | 16,581.06 | 3,989.00 | 4,731.55 | 4,126.84 | 7,944 | 3,686.86 | 7003.637 | 9161.438 | 2,505.74 | 3,002.78 |
| **Dhjetor** | 4,335.12 | 4,083.50 | 4,994.85 | 4,387.13 | 8,572 | 3,360.50 | 15836.706 | 18946.847 | 3,514.24 | 16,028.79 |

*Krahasimi i gjenerimit me periudhën e njejtë për vitet 2016-2025*

Gjatë TM4 2025, niveli i ujit në liqenin e Ujmanit ka pësuar ndryshime si pasojë e kushteve hidrologjike:

- **Prurjet mesatare:** në Tetor prurjet ishin 7.4 $m^3/s$ , ndërsa në Dhjetor u rritën ndjeshëm në 17.4 $m^3/s$.
- **Nivelet:** periudha filloi më 1 Tetor me nivelin 683.17 m (282 mil. $m^3$) dhe përfundoi më 31 Dhjetor me nivelin 684.90 m (297 mil. $m^3$).
- **Menaxhimi:** gjatë Dhjetorit është bërë menaxhim intensiv për të krijuar hapësirë për prurjet e ardhshme, duke rezultuar në një ulje prej 23 milionë $m^3$ brenda muajit (nga 320 mil. $m^3$ në 297 mil. $m^3$)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë grafike prurjet mesatare mujore:




Prurjet mesatare në akumulimin Ujmanit gjatë tremujorit TM4 ishin **2,93** $m^3$/sec

**Përmbledhja e luhatjeve të nivelit (1 Tetor – 31 Dhjetor 2025)**

- **Fillimi i Tetorit (Faza e Thatësisë):** më 1 tetor, niveli i ujit ka qenë në kuotën **683.17 m**, me një vëllim prej **282 mil. m³**. Prurjet mesatare ishin të ulëta, rreth **7.4 m³/s.**
- **Stabiliteti dhe Rritja Graduale:** gjatë muajit tetor, niveli ka shënuar një rritje të lehtë, duke arritur në fund të muajit në kotën **683.92 m (289 mil. m³)**.
- **Piku i Akumulimit (Fillimi i Dhjetorit):** pas një rritjeje të vazhdueshme gjatë nëntorit, niveli i ujit ka arritur kulmin më 1 dhjetor në kotën **687.32 m**, me një vëllim maksimal prej **320 mil. m³**.
- **Faza e Menaxhimit dhe uljes së nivelit:** si pasojë e prurjeve rapide dhe të mëdha mesatare prej **17.4 m³/s** gjatë dhjetorit, kem aplikuar një menaxhim intensiv për të krijuar hapësirë për prurjet e ardhshme.
- **Mbyllja e Vitit:** kjo ka rezultuar në një ulje të qëllimshme të nivelit prej **23 milionë m³** brenda muajit dhjetor. Më 31 dhjetor, niveli ka përfunduar në kotën **684.90 m (297 mil. m³)**

| | **Vëllimi $10^6 m^3$** | **Prurjet $m^3$/sec** |
|---|---|---|
| Tetor | **289** | **7.4** |
| Nëntor | **320** | **17.4** |
| Dhjetor | **297** | **17.4** |

| | Prurjet gjatë viteve $m^3/sec$ | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2025** | **2024** | **2023** | **2022** | **2021** | **2020** | **2019** | **2018** | **2017** | **2016** |
| ***Tetor*** | 7.4 | 3.69 | 5.3 | 5.8 | 4.60 | 10.17 | 3.4 | 5.32 | 3.3 | 9.3 |
| ***Nëntor*** | 17.4 | 3.5 | 19.6 | 26.6 | 2.80 | 4.5 | 6.5 | 3.5 | 8.4 | 31.1 |
| ***Dhjetor*** | 17.4 | 8.38 | 24.7 | 28.5 | 11.70 | 12.9 | 10.3 | 6.12 | 14.1 | 5.3 |



## Analiza e Trendit sipas Viteve

### Viti 2023: stabilitet dhe prurje të mëdha

Viti 2023 u mbyll me një situatë mjaft komode. Ndonëse kishte shfrytëzim të lartë për energji, prurjet e mëdha të dhjetorit (mesatarisht **24.7** ) mbajtën nivelin mbi kuotën 684 m. Kjo siguroi një rezervë solide për fillimin e vitit 2024.

### Viti 2024: kriza e thatësisë dhe rënia drastike

Ky ishte viti më kritik i analizuar.

- **Humbja e Vëllimit:** nga fundi i vitit 2023 në fundin e vitit 2024, liqeni humbi rreth **47 milionë** ujë.
- **Arsyet:** mungesa e reshjeve gjatë gjithë TM4 (prurjet ranë në vetëm **5.19** ) dhe temperaturat e larta që rritën avullimin.
- **Niveli Kritik:** kota prej **678.46 m** ishte shumë pranë niveleve që kërkojnë kufizime strikte të shfrytëzimit.

### Viti 2025: rikuperimi dhe menaxhimi strategjik

Ky vit shënoi një kthesë pozitive, duke rikthyer liqenin në parametra optimalë.

- **Luhatja brenda TM4:** liqeni nisi tetorin me **282 mil.** dhe arriti kulmin në fillim të dhjetorit me **320 mil.** .
- **Zbrazja e Qëllimshme:** për herë të parë në këtë periudhë, shohim një rënie të qëllimshme prej **23 milionë** brenda dhjetorit (nga 320 në 297 mil. ). Ky nuk ishte deficit, por **menaxhim i hapësirës absorbuese** për të parandaluar tejmbushjen nga prurjet rapide prej **17.4** .




| | Prurjet gjatë viteve $m^3$/sec | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2024** | **2023** | **2022** | **2021** | **2020** | **2019** | **2018** | **2017** | **2016** |
| ***Tetor*** | 3.69 | 5.3 | 5.8 | 4.60 | 10.17 | 3.4 | 5.32 | 3.3 | 9.3 |
| ***Nëntor*** | 3.5 | 19.6 | 26.6 | 2.80 | 4.5 | 6.5 | 3.5 | 8.4 | 31.1 |
| ***Dhjetor*** | 8.38 | 24.7 | 28.5 | 11.70 | 12.9 | 10.3 | 6.12 | 14.1 | 5.3 |

Niveli i ujit në liqe me 1 Tetor ka qenë në kotën 683.17 m (282 mil. m3 ,shkalla 66.5) 31 Dhjetor niveli ka qenë në kotë 55.5)





Niveli i Akumulimit në pendën "Ujëmani" gjatë periudhës kohore TM4 ndër vitet 2016-2025
692
690
688
686
684
682
680
678
676
674
672
670
1 3 5 7 9 11 13 15 17 19 21 23 25 27 29 31 33 35 37 39 41 43 45 47 49 51 53 55 57 59 61 63 65 67 69 71 73 75 77 79 81 83 85 87 89
2016
2017
2018
2019
2020
2021
2022
2023
2024
2025

## 2. *Zyra e shitjes* :

Nga Zyra e shitjes statistikat për TM4 -2025 , janë të paraqitura si në tabelat në vijim :

| TM4 Shitja e Energjisë Elektrike | |
|---|---|
| **Muaji** | **Vlera €** |
| **Tëtor** | € 448,384.54 |
| **Nëntor** | € 383,791.64 |
| **Dhjetor** | € 2,072,674.12 |
| **Total** | **€ 2,904,850.30** |

| TM4 Shitja e Ujit të Papërpunuar | |
|---|---|
| **Muaji** | **Vlera €** |
| **Tëtor** | € 198,991.14 |
| **Nëntor** | € 146,496.33 |
| **Dhjetor** | € 179,167.70 |
| **Total** | **€ 524,655.17** |






# 3. Departamenti "Ujitja"

Departamenti "Ujitja" me tri Njësit Punuese Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran gjatë muajve Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2025 ka vazhduar me aktivitetet, konform detyrave dhe përgjegjësive që dalin nga rregullorja për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes gjatë sezonit të Dimrit.

Në fillim të muajit Tetor, më të përfunduar sezoni i ujitjes, punët kanë vazhduar në dy drejtime:

1. Rehabilitimin e dëmeve në sistemin e ujitjes që nuk ishin riparuar gjatë sezonit të ujitjes për të mos ndërprerë furnizimin me ujë, dhe
2. Zbrazjen e sistemit të ujitjes dhe përgatitjen e tij për sezonin dimëror.

Gjatë muajit Tetor, në të tri Njësitë Punuese është punuar në zbrazjen e sistemin e ujitjes, si dhe në sanimin e defekteve të ngelura nga sezoni i ujitjes, pra, ekipi i mirëmbajtjes ka bërë funksionalizimin e të gjithë gypave dhe hidrantave të dëmtuar. Ndërsa teknikët e meliorimeve dhe evidentuesit kanë vazhduar punën në inkasimin e mjeteve, mbledhjen e pajisjeve nga fermerët që nuk kanë kontraktuar, dhe përgatitjen e dokumentacionit (kontratave dhe proceseve) për faturim. Janë përgatitur regjistrat e fermerëve për faturim dhe janë dorëzuar në Departamentin e Financave. Së bashku me Udhëheqësit e Njësive punuese dhe në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesore Financiar kanë punuar në përgatitjen e Planit të biznesit për vitin 2026.

Gjatë muajit Tetor sistemi i ujitjes është zbrazur në tërësi, ndërsa gjatë muajit Nëntor ka vazhduar puna për përgatitjen e sistemit për dimërim. Janë konzervuar dhe vajosur të gjitha pjesët fazonerike të prodhuara nga metali, janë larguar grilat nga ujëmarrësit, si dhe janë mbuluar të gjitha pusetat. Të gjitha Stacionet Pompike, është bërë zbrazja e bazenave kompensues para Stacioneve Pompike, janë larguar rrjetat dhe janë vendosur blindat në gypat thithës të Stacioneve Pompike. Gjithashtu është bërë edhe vajosja dhe konservimi i pompave dhe i tërë fazonerisë që gjendet ne Stacionet Pompike. Për punëtorët e terenit të cilët kanë punuar me orar të zgjatur gjatë verës, janë llogaritur orët e punës jashtë orarit dhe sipas planit punëtoret do ti dërgojmë në pushim.

Gjatë muajit Dhjetor, gjegjësishtë më datë 4 Dhjetor, kemi pritur në vizitë një delegacion nga Franca, nga kompania SCP, *(Société du Canal de Provence ( SCP ) është një kompani publike lokale përgjegjëse për menaxhimin, shpërndarjen dhe zhvillimin e burimeve ujore në rajonin e Provencës),* kjo vizitë është në kuader të bashkëpunimit në mes të N.H."Ibër-Lepenc"Sh.A dhe SCP-së nga Franca. Së bashku me ekipin nga Franca kemi vizituar Nj.P. në Vushtrri, Stacionin Pompik në Samadrexhë dhe kemi bërë një vizitë të një fermer në fshatin Akrashticë. Ekipin nga Franca e kemi informuar rreth operimit dhe mirëmajtjes si dhe funksionimit të sistemit të ujitjes. Në vazhdimësi jemi në kontakt përmes E-mailave, dhe jemi duke u derguar të dhëna rreth sistemit të ujitjes në kompaninë tonë. Gjatë muajit Dhjetor, në Njësitë Punuese:Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran, aktivitetët kanë rënë si rezultat i sezonës Dimërore, por punët kanë vazhduar në kontrollimin e infrastrukturës së ujitjes, në mënyrë që sistemi i ujitjes të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet e ndryshme keqbërëse. Meqenëse sifoni në Korroticë, Komuna e Drenasit, kishte rrjedhje gjatë sezonit të ujitjes 2025, menduam që defekti është në lidhsen e gypit të çelikut më gypin azbest-cemen dhe se ne nuk kemi mundësi për ta riparuar, pas konsultimeve edhe më DPZH-në u vendos që sanimi të realizohej përmes projektit të përfshirë në planin e biznesit 2026. Më kërkesën e Inxhinjerit të DPZH-së tanë u vendos që gypi i Sifonit të zbulohet. Gjatë punimeve u konstatua se rrjedhja nuk ishte nga lidhsja e gypit të çelikut më gypin azbest-cement por rrjedhja e ujit ishte nga

lidhësja në mes të dy gypave azbest-cement Ø1200, kështu që punëtorët e Nj.P. në Komoran e kthyen lidhësen në vendin e saj dhe gypi i Sifonit u mbulua. Gjendja do të monitorohet pas lëshimit të ujit dhe gjatë sezonit të ujitjes, dhe në rast të paraqitjes së rrjedhjeve të reja do të ndërmerren masa shtesë.

Do të propozojm që ky projekt të largohet nga Plani i Biznesit 2026.

Gjatë muajit Dhjetor punët kanë vazhduar në disa drejtime:

- Kontrollimi vizuel i infrastrukturës së ujitjes nëpër Njësitë Punuese.
- Regjistrimi i aseteve nëpër Njësitë Punuese.
- Inkasimi i borxheve të papaguara nga fermeret, etj.

Pjesa më e madhe e punëtorve janë duke i shfrytëzuar pushimet vjetore dhe ditët e lira që i kanë si rezultat i orarit të zgjatur gjatë sezonës së ujitjes. Më datë 31.12.2025, jemi informuar se në S.P. në Korroticë ka ndodhur një vjedhje e rëndë, mënjëherë janë informuar Policia e Kosovës dhe punëtorët përgjegjës janë suspenduar më vendim timin . Departamenti "Ujitja" po e përmbyll muajin Dhjetor me këtë rast edhe vitin 2025, një vit i cili ka qenë i mbushur me sfida të shumta, të cilat i kemi kaluar me sukses. Megjithatë, pavarësisht sfidave dhe vështirësive, kemi arritur që të tejkalojm Planin e ujitjës për vitin 2025, nga 1900.00 ha, që ishte plani kemi arritur të kontraktojmë 2139.45 hektarë, apo rreth 12.6% më shumë se sa plani. Pra, kemi ofruar shërbime gjatë gjithë sezonit të ujitjes për rreth 9813,000 hektar toke bujqësore dhe kemi mbajtur sistemin e ujitës me një presion nga 2.5 deri në 5 bar. Me një sipërfaqe të ujitëse prej 2139.45 hektarë, vitin 2025 e konsiderojmë të përfunduar me sukses, dhe si rezultat kemi kontribuar në zhvillimin e bujqësisë dhe mirëqenien e komunitetit në komunat ku shtrihet sistemi i ujitjes.

T*ab.1.Paraqitja tabelare e siperfaqëve të instaluara, të rehabilituara, të ujitura nëpër vitet*

*2022- 2024, të planifikuara për vitin 2025 dhe te ujitura dreri me 30 Shtator 2025*

| Nr. | Njësia Punuese | Sipërfaqë e instaluara ha. | Sipërfaqë e rehabilituara ha. | Sipërfaqë e ujitura ha. 2022 | Sipërfaqë e ujitura ha. 2023 | Sipërfaqë e ujitura ha. 2024 | Sipërfaqë e planifikuara ha. 2025 | Sipërfaqë e ujitura ha. 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Vushtrri | 7200.00 | 4500.00 | 734.28 | 655.30 | 824.39 | 850.00 | 967.98 |
| 2 | Shkabaj | 7100.00 | 2500.00 | 685.81 | 601.66 | 727.39 | 740.00 | 763.82 |
| 3 | Komoran | 5620.00 | 2813.00 | 459.63 | 111.37 | 200.84 | 310.00 | 407.65 |
| | **TOTALI:** | 19920.00 | 9813.00 | 1879.72 | 1368.33 | 1752.62 | 1900.00 | **2139.45** |




**Konkluzion**

Departamenti"Ujitja" gjatë tre mujorit të katërt (Tetor, Nëntor dhe Dhjetor), bazuar në Planin e biznesit për vitin 2025 ka realizuar objektivat në:

- Zbrazjen e sistemit të ujitjes në fund të sezonit;

-Sanimin e defekteve të mbetura nga sezoni i ujitjës;

- Përgatitjen e sistemit të ujitjes për sezonin dimëror (Konzervimin e Hidrosistemit).

Më Planin e Biznesit të vitit 2025, kemi paraparë që fermerët mund të ujisin rreth 1900 ha, por përgatitja më kohë e sistemit të ujitjes, mirëmbajtjes të mirë dhe furnizimit më ujë më sasi dhe cilësi të duhur të fermerve, gatishmeria e fermerve për të ujitur kulturat bujqësore, si dhe Marrëveshët e Bashkëpunimit ndërmjet N.H "Iber-Lepenc" dhe komunave Vushtrri, Obiliq, Prishtine dhe Mitrovicë dhe Drenas, mbretërimi i kushteve të mira atmosferike, fermerët e kanë shfrytëzuar ujin për ujitjen e kulturave bujqësore për 2139.45 Ha, e që në përqindje i bie se Plani i ujitjes është tejkaluar për rreth 12.6 %. Bazuar në të gjitha vështërsit që po e përcjellin sektorin e ujitjes si dhe për kundër subvencionimit të ujitjes nga komunat Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Mitrovicë, Drenas dhe NH "Iber-Lepenc", ujitja e tokave bujqësore varet drejt për se drejti nga fermerët, nga niveli i zhvillimit të tyre, nga tregu i brendshëm dhe i jashtëm si dhe nga shumë faktor të tjerë, e që N.H.„Ibër-Lepenc" nuk mund të ndikoj. Mbetët që Departamenti "Ujitja" se bashku me Kryeshefin Ekzekutiv dhe Bordin e Drejtorëve të angazhohet maksimalisht për të vënë në lëvizje të gjithë aktoret relevante për zhvillimin e bujqësisë ne Republikën e Kosovës. Duhet theksuar se Departamenti"Ujitja" ka ofruar shërbime në këto komuna: Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Drenas, në 98123.00 ha. por fermerët bazuar në kushtet dhe rrethanat e lartcekura kanë ujitur vetëm **2139.45 Ha**.

# 4. Shërbimi i Financave

## Të hyrat

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025 të hyrat e ndërmarrjes janë realizuar në vlerë **3,691,785** €, ndërsa ishin planifikuar të realizohen në vlerë prej **3,200,650 €** që do të thotë se të hyrat e realizuara janë për **15%** më të larta se të planifikuara dhe për **39.2%** më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

- Nga energjia elektrike janë realizuar të hyrat në vlerë prej **2,917,619 €**, ndërsa kanë qenë të planifikuara të realizohen të hyrat në vlerë **2,205,000 €** apo shprehur në përqindje realizimi ishte më i lartë për **32.3%** se planifikimi dhe për **75 %** më i lartë se realizimi në periudhën e njëjtë të vitit papraprak.
- Nga shitja e ujit të papërpunuar janë realizuar të hyrat në vlerë prej **524,655€**, ndërsa të planifikuara ishin **564,320€**. Realizimi ishte për **2%** më i ultë se planifikimi dhe për **11 %** më i ultë në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak.
- Të hyrat tjera në vlerë **14,105** € janë kryesisht të ardhura nga interesi bankar.
- Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të hyrat sipas llojit, sasisë dhe vlerës monetare:

**Tabela nr. 1 RAPORTI I BIZNESIT PËR PERIUDHËN TM4 2025**

| N.r. | Emërtimi | Nj.mat. | Realizimi TM 4 2024 | Plani TM 4 2025 | Realizimi TM 4 2025 | Indeks i (realizimi/plani) | Indeksi (realizimi 2025/2024) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 (5:4) | 7(5:3) |
| 1 | **PRODHIMI** | | | | | | |
| 1.1 | Energjia elektrike | Mwh | 8,900.56 | 21,000.00 | 21,470.72 | 102.24 | 241.23 |
| 1.2 | Uji | m³ | 15,473,882.00 | 14,619,760 | 13,874,790 | 94.90 | 89.67 |
| 1.3 | Ujitja | ha | 1,752.620 | 1,900.000 | 2,140.050 | 112.63 | 122.11 |
| | | | | | | | |
| 2 | **TË HYRAT** | | **2,652,141** | **3,200,650** | **3,691,785** | **115.34** | **139.2** |
| 2.1 | Energjia elektrike | € | 1,665,932 | 2,205,000 | 2,917,619 | 132.32 | 175.13 |
| 2.2 | Uji | " | 589,083 | 564,320 | 524,655 | 92.97 | 89.06 |
| 2.3 | Ujitja | " | 192,788 | 209,000 | 235,405 | 112.63 | 122.11 |
| 2.4 | Të tjera | " | 204,338 | 222,330 | 14,105 | 6.34 | 6.90 |

| | | | Realizimi TM 4 2024 | Plani TM4 2025 | Realizim TM4 2025 | Indeksi realizim i/plani | Indeksi 2025/2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | SHPENZIMET | | 1,149,232 | 1,488,337 | 1,782,073 | 120 | 155 |

## Shpenzimet

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025 shpenzimet e ndërmarrjes kanë arritur vlerën prej **1,782,073 €**, ndërsa ishin planifikuar të shpenzohen **1,488,337 €**. Realizimi i shpenzimeve është më i lartë për **20%** në krahasim me planin dhe për **55 %** më i lartë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Shpenzimet kryesore të ndërmarrjes gjatë këtij 3 mujori janë në paga dhe meditje, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve janë kryesisht taksat e ndryshme për rregullatorë, shpenzimet komunale, pastaj shpenzimet e karburanteve dhe shpenzimet e mirëmbajtjes. Në vijim janë paraqitur në formë analitike të gjitha shpenzimet e ndodhura gjatë periudhës tetor-dhjetor 2025:

### Tabela nr. 2. Raporti analitik i shpenzimeve

| Kodi | Kategoria e shpenzimeve | Realizimi TM4 2024 | Plani TM 4 2025 | Realizimi TM4 2025 | Indeksi % | Indeksi % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4=(3:2) | 5=(3:1) |
| **B.1** | **Pagat dhe meditjet** | **858,025** | **1,087,115** | **1,161,231** | 106.8 | 135.3 |
| B.1.1 | Pagat neto të punëtorëve | 556,475 | 783,921 | 692,686 | 88.4 | 124.5 |
| B.1.2 | Pagat jasht orarit | 12,594 | 11,050 | 18,053 | 163.4 | 143.3 |
| B.1.3 | Pagat tjera ( Bonuset) | 69,291 | 0 | 159,611 | n/a | 230.3 |
| B.1.4 | Paga përcjellëse | 0 | 4,856 | 4,844 | 99.8 | n/a |
| B.1.5 | Shujta | 58,456 | 71,810 | 67,680 | 94.2 | 115.8 |
| B.1.6 | Tatimi në paga | 53,838 | 72,183 | 77,208 | 107.0 | 143.4 |
| B.1.7 | Kontributi i ndërmarrjes 5% | 40,619 | 53,947 | 55,058 | 102.1 | 135.5 |
| B.1.8 | Kontributi i puntorit 5% | 40,619 | 53,947 | 55,058 | 102.1 | 135.5 |
| B.1.9 | Antarsia Sindikale | 2,710 | 0 | 3,221 | n/a | 118.9 |
| B.1.10 | Shërbimi shëndetësor | 14,555 | 26,550 | 18,944 | 71.4 | 130.2 |
| B.1.11 | Pagat e Bordit | 8,868 | 8,850 | 8,868 | 100.2 | 100.0 |
| **B.2** | **Shpenzimet e udhëtimëve zyrtare dhe reprezentacionet** | **6,109** | **5,920** | **19,400** | 327.7 | 317.5 |
| B.2.1 | Shpenzimet e udhëtimëve zyrtare | 442 | 2,980 | 9,504 | 318.9 | 2152.7 |
| B.2.2 | Shpenzimet e reprezentacionit | 5,668 | 2,940 | 9,895 | 336.6 | 174.6 |
| **B.3** | **Shpenzimet e marketingut** | **0** | **900** | **0** | 0.0 | 0.0 |
| B.3.2 | Shpenzimet e marketingut | 0 | 900 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| **B.4** | **Shpenimet e mirëmbajtjës** | **7,254** | **34,827** | **27,263** | 78.3 | 375.9 |
| B.4.1 | Mirembajtja dhe servisimi i automjeteve | 2,706 | 8,787 | 8,159 | 92.9 | 301.5 |
| B.4.2 | Mirëmb.e objekteve dhe paisjeve | 1,001 | 6,720 | 13,014 | 193.7 | 1300.7 |
| B.4.3 | Mirëmbatja infrastrukturore | 0 | 6,600 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| B.4.4 | Mirëmbajtja tekniko-informative | 3,547 | 12,720 | 4,885 | 38.4 | 137.7 |
| B.4.5 | Servisimi dhe mbushja e aparatave kundër zjarrit | 0 | 0 | 1,206 | n/a | n/a |
| **B.5** | **Shpenzimet komunale** | **46,683** | **61,852** | **51,426** | 83.1 | 110.2 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| B.5.1 | Shpenzimet e ujit | 534 | 1,075 | 693 | 64.5 | 129.8 |
| B.5.2 | Shpenzimet për mbeturina | 593 | 786 | 496 | 63.2 | 83.8 |
| B.5.3 | Energjia Elektrike | 43,378 | 57,729 | 50,236 | 87.0 | 115.8 |
| B.5.4 | Shpenzimet e ngrohjes (Termokos) | 2,179 | 2,261 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| **B.6** | **Material harxhues** | **2,681** | **6,870** | **4,490** | 65.4 | 167.5 |
| B.6.1 | Artikuj me vlerë të vogël | 1,746 | 750 | 4,191 | 558.8 | 240.1 |
| B.6.2 | MHT-mbrojtja higjeno-teknike | 794 | 0 | 115 | n/a | 14.4 |
| B.6.3 | Material elektrik | 112 | 270 | 66 | 24.3 | 58.5 |
| B.6.4 | Material higjenik | 28 | 1,860 | 102 | 5.5 | 360.2 |
| B.6.5 | Material për zyre | 0 | 3,990 | 17 | 0.4 | n/a |
| **B.7** | **Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes** | **18,041** | **8,000** | **6,832** | 85.4 | 37.9 |
| B.7.1 | Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes | 18,041 | 8,000 | 6,832 | 85.4 | 37.9 |
| **B.8** | **Shpenzimet për shërbime** | **3,555** | **41,320** | **778** | 6.5 | 21.9 |
| B.8.1 | Trajnime | 3,456 | 11,850 | 744 | 6.3 | 21.5 |
| B.8.2 | Shpenzime te shtypjes | 99 | 150 | 34 | 22.6 | 34.2 |
| B.8.3 | Shpenzime projektuese | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| B.8.4 | Shpen.sherbimeve ligjore | 0 | 29,320 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| **B.9** | **Shpenzime tjera** | **17,800** | **42,960** | **152,811** | 355.7 | 858.5 |
| B.9.1 | Shpenzime tjera | 11,829 | 41,010 | 151,844 | 370.3 | 1283.6 |
| B.9.2 | Parkingu për automjete | 505 | 1,350 | 757 | 56.1 | 150.0 |
| B.9.3 | Autolarja | 164 | 300 | 210 | 70.0 | 128.0 |
| B.9.4 | Çregjistrimet | 5,172 | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| B.9.5 | Konkurset | 130 | 300 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| **B.11** | **Shpenzimet e telekomunikimit** | **6,042** | **7,424** | **6,338** | 85.4 | 104.9 |
| B.11.1 | Telefonia fikse | 116 | 330 | 218 | 66.2 | 187.7 |
| B.11.2 | Telefonia mobile | 1,634 | 1,928 | 1,794 | 93.1 | 109.8 |
| B.11.3 | Kablloviku | 212 | 41 | 100 | 246.3 | 47.0 |
| B.11.4 | Interneti | 4,055 | 5,066 | 4,201 | 82.9 | 103.6 |
| B.11.5 | Shpenzimet postare | 24 | 60 | 25 | 41.7 | 106.2 |
| **B.13** | **Derivatet** | **12,753** | **14,135** | **12,430** | 87.9 | 97.5 |
| B.13.1 | Nafta | 12,219 | 12,680 | 12,112 | 95.5 | 99.1 |
| B.13.2 | Benzina | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| B.13.3 | Vajrat | 534 | 1,455 | 318 | 21.9 | 59.7 |
| **B.14** | **Detyrime kontigjente** | **0** | **0** | **0** | 0.0 | 0.0 |
| B.14.1 | Detyrime kontigjente | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| **B.15** | **Provizionet dhe taksat** | **170,289** | **170,715** | **326,305** | 191.1 | 191.6 |
| B.15.1 | Tatimi ne pronë | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| B.15.2 | Taksa për rregullatorë | 33,413 | 71,823 | 131,047 | 182.5 | 392.2 |
| B.15.2.1 | Taksa për MMPH | 72,586 | 93,865 | 100,692 | 107.3 | 138.7 |
| B.15.3 | Provizioni bankar | 710 | 300 | 980 | 326.6 | 138.1 |
| B.15.4 | Sigurimi i automjeteve | 1,476 | 2,928 | 2,371 | 81.0 | 160.6 |
| B.15.5 | Regjistrimi i automjeteve | 1,416 | 1,800 | 2,094 | 116.3 | 147.9 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| B.15.6 | Interesi i kredisë BB | 60,688 | 0 | 89,121 | n/a | 146.9 |
| B.15.7 | Tatimi në fitim | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| **B.16** | **Kompenzimi i dëmëve** | **0** | **6,300** | **0** | 0.0 | 0.0 |
| B.16.1 | Kompenzimi i dëmëve | | 6,300 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| **B.17** | **Shpenzimet nga imbalanca** | **0** | **0** | **12,770** | n/a | n/a |
| B.17.1 | Shpenzimet nga imbalanca | 0 | 0 | 12,770 | n/a | n/a |
| **B.30** | **Total** | 1,149,232 | 1,488,337 | 1,782,073 | 122.1 | 155.1 |

**Rezultati financiar**

Gjatë këtij tremujori ndërmarrja ka pasur rezultat pozitiv financiar në vlerë prej **752,669** €. Në vijim mund të shihet pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**Tabela 3. Pasqyra e të ardhurave TM4 2025**

| Pasqyra e të ardhurave dhe Shpenzimeve | TM4 2025 (€) | TM4 2024 (€) |
|---|---|---|
| | | |
| Të Hyrat nga shitja energjisë elektrike | 2,811,276 | 1,602,648 |
| Të Hyrat nga jobalanca pozitive | 106,343 | 63,119 |
| Të Hyrat nga shitja e ujit me shumicë | 524,655 | 589,083 |
| Të Hyrat nga ujitja | 235,406 | 192,788 |
| Të Ardhurat tjera | 14,106 | 202,238 |
| **Total të hyrat dhe të ardhurat bruto** | **3,691,785** | **2,649,876** |
| | | |
| Pagat dhe meditjet | 1,161,231 | 858,025 |
| Shpenzimet për udhëtime zyrtare | 9,504 | 442 |
| Reprezentacioni | 9,895 | 5,668 |
| Shpenzimet e marketingut | 0 | 0 |
| Shpenzimet e mirëmbajtjes | 27,263 | 7,254 |
| Shpenzimet komunale | 51,426 | 46,683 |
| Material hargjues | 4,490 | 2,681 |
| Material për rrjetin e ujitjes | 6,832 | 18,041 |
| Shpenzime për shërbime | 778 | 3,555 |
| Shpenzime tjera | 152,811 | 17,800 |
| Shpenzimet telekomunikuese | 6,338 | 6,042 |
| Derivatet | 12,430 | 12,753 |
| Kompenesimi dhe taksat | 326,305 | 170,289 |
| Kompensimi i dëmeve | 0 | 0 |
| Shpenzimet nga imbalanca | 12,770 | 0 |
| **Totali i shpenzimeve** | **1,782,073** | **1,149,232** |
| | | |
| **Fitimi/humbja operative** | **1,909,712** | **1,500,644** |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Total zhvlerësimi** | **1,157,043** | **1,154,658** |
| | | |
| **Total fitimi (humbja) neto** | **752,669** | **345,986** |

## 5. Zyra e prokurimit

Gjatë tremujorit të katër 2025 (TM4- 2025), Departamenti i Prokurimit ka zhvilluar këto aktivitete:

| *#* | *Nr prok* | *Titulli* | *Data e inicimit* | *Procedura dhe vlera e parashikuar* | *Data e hapjes* | *Nënshkrimkontrate* | *Vlera e kontratës* | *Kompania fituese* | *Komente* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | 25_034 | **Furnizim me paisje gjeodezike dhe paisje percjellse** | 16.04.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 60,000.00 € | 23.05.2025 | 07.07..2025 | 54,162.00 € | **OE "DWH-KOSOVA SH.P.K.** | **KONTRAKTUAR!** |
| **2** | 25_043 | **Rehabilitimi i objektit-punetorise se Autoparkut, çatia, depoja, objekti i rojes, rregullimi i zyres se punetoreve, ndarja e terminalit, si dhe rregulllimi i zyreve te Arkives** | 15.05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 150,000.00 € | 09.06.2025 | 02.07.2025 | 150,054.73 € | **GOE "IBM SH.P.K." : "BABAJ COMPANY SH.P.K."** | **KONTRAKTUAR!** |
| **3** | 25_050 | **OFRIMI I SHËRBIMIT JURIDIK PËR PËRFAQËSIM NË GJYKATË KOMERCIALE DHE INSTANCAT TJERA MË TË LARTA** | 16.05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 100,000.00 € | 16.06.2025 | 10.07.2025 | 87,583.14 € | **OE "SEJDIU & QERKINI" SH.P.K.** | **KONTRAKTUAR!** |
| **4** | 25-051 | **Furnizim me licenca për Microsoft Office 365 për nevojat e N.H. "Iber-Lepenci" sh.a** | 20..05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 48,900.00 € | 11.06.2025 | 04.07.2025 | 34,087.84 € | **OE "Cacttus" Sh.a** | **KONTRAKTUAR!** |
| **5** | 25_038 | **Renovimi i Objektit te Drejtorise-RITENDER** | 21.05.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 670,000.00 € | 07.07.2025 | 30.07.2025 | 649,952.77 € | **GOE "BABAJ COMPANY SH.P.K." : "IBM SH.P.K."** | **KONTRAKTUAR!** |
| **6** | 25_037 | **Sanimi i gypit te demtuar te çelikut ne shtratin e lumit Iber - Ritender** | 13.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 12,000.00 € | 07.07.2025 | | | | **Anuluar, pas pranimit te nje oferte te papergjegjshme!** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **7** | 25_014 | Furnizim me fazoneri - RITENDER 2 | 26.06.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 150,000.00 € | 13.08.2025 | | | | **Anuluar, asnje oferte e pranuar!** |
| **8** | 25_063 | Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran | 17.07.2025 | Vlerë Minimale 500.00 € | 18.07.2025 | | | | **Anuluar, asnje oferte e pranuar!** |
| **9** | 25_065 | Servisim i veturave | 23.07.2025 | Vlerë Minimale 336.00 € | 24.07.2025 | 28.07.2025 | 400.02 | **OE "Ramadan Raçi" B.I.** | **KONTRAKTUAR!** |
| **10** | 25_067 | Furnizimi me kutia për dhënien e ndihmës së parë, të vendosura në mure | 24.07.2025 | Vlerë Minimale 600.00 € | 25.07.2025 | / | / | / | **Anuluar, oferta e vetme e pranuar e ka tejkaluar emimin e parashikuar!** |
| **11** | 25_063 | Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran - Retender | 28.07.2025 | Vlerë Minimale 500.00 € | 29.07.2025 | / | / | / | **Anuluar, asnje oferte e pranuar!** |
| **12** | 24_054 | Digjitalizimi, vektorizimi, gjeoreferencimi i projekteve te profiit gjatesor te kanalit, hartave te ujitjes dhe largperquesve | 31.10.2024 | E hapur Vlerë e mesme 50,000.00 € | 25.11.2024 | / | / | / | **Sipas Vendimit te Panelit te OSHP: 2025/0308, aktiviteti eshte anuluar.** |
| **13** | 25_016 | Rindertimi segmenteve të pjesëve të Kanalit Besi-Graçankë | 20.02.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 450,000,00 € | 24.03.2025 | / | / | / | **Sipas Vendimit te Panelit te OSHP: 2025/0337, aktiviteti eshte anuluar.** |
| **14** | 25_027 | Furnizim me Vetura me rimorkio për terren (6 copë)- RITENDER | 17.03.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 360,000.00 € | 05.05.2025 | / | / | / | **Sipas Vendimit te Panelit te OSHP: 2025/0523, aktiviteti eshte anuluar.** |
| **15** | 25_053 | Furnizim me Kamioneta | 02.06.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 300,000.00 € | 22.07.2025 | 15.08.2025 | 279,188.00 € | **OE "Profitech" SH.P.K.** | **KONTRAKTUAR!** |
| **16** | 25_052 | Furnizimi dhe montimi i pjesëve për Nisan Qashqai dhe Reno Clio. - RITENDER | 16.06.2025 | E hapur Vlerë e Vogël 2,190.00 | 24.06.2025 | 09.07.2025 | 2,189.99 € | **OE "Auto Mita" SH.P.K** | **KONTRAKTUAR!** |
| **17** | 25_057 | Furnizimi me pjesë rezervë për mirëmbajtjen e automjeteve dhe makinerive. | 19.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 18,909.00 € | 16.07.2025 | 07.08.2025 | 18,334.38 € | **OE "Ramadan Raci" B.I.** | **KONTRAKTUAR!** |
| **18** | 25_058 | Furnizim dhe servisimin e aparateve për | 19.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme | 16.07.2025 | 14.08.2025 | 10,893.76 € | **OE NPSH** | **KONTRAKTUAR!** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbrojtje kundër zjarrit | | 12,000.00 € | | | | "Emergj enca" | |
| **19** | 25_06 2 | Furnizimi me pompa të ujit për nevoja operative | 26.06.202 5 | E hapur Vlerë e Mesme 6,000.00 € | 08.07.202 5 | 22.08.202 5 | 3,246.1 8 € | **OE "INFINI TT" SH.P.K.** | **KONTRAKTUA R!** |
| **20** | 25_03 7 | Sanimi i gypit te demtuar te çelikut ne shtratin e lumit Iber - Ritender 2 | 18.07.202 5 | E hapur Vlerë e Mesme 12,000.00 € | 11.08.202 5 | / | / | / | **Anuluar, asnje oferte e pranuar!** |
| **21** | 25_06 6 | Aneks - Riparimi i pompave të Drenazhes në SP Besi dhe SP Bivolak, Rehabilitimi i pompave në SP Samadregje. | 21.07.202 5 | E hapur Vlerë e Vogël 1,098.58 € | 24.07.202 5 | 05.08.202 5 | 1,097.4 0 € | **OE "AL Group" SH.P.K.** | **KONTRAKTUA R!** |
| **22** | 25_04 4 | Furnizim me mjete mbrojtëse në punë - RITENDER | 21.07.202 5 | E hapur Vlerë e Mesme 25,500.00 € | 15.08.202 5 | / | / | / | **Anuluar, pranuar vetem nje oferte te papergjegjshme per shperblim me kontrate!** |
| **23** | 25_06 3 | Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran - Retender | 28.07.202 5 | 500.00 € | 29.07.202 5 | | | | **Anuluar, asnje oferte e pranuar!** |
| **24** | 25_06 8 | Zhvendosja Rivendosja e inventarit punues në faza të drejtorisë së Ibër-Lepencit | 05.08.202 5 | 9,950.00 € | 11.08.202 5 | / | / | / | **Anuluar, me datë 15.08.2025 Operatori Ekonomik fitues ka dërguar një e-mail, ku për shkak të ndryshimit të lokacionit të zhvendosjes, ka kërkuar që të bëhet anulimi i procedurës!** |
| **25** | 25_06 4 | Digjitalizim, vektorizimi dhe krijimii Sistemit Elektronik i menaxhimit te Arkives dhe WEBGIS | 06.08.202 5 | 500,000.00 € | | | | | **Anuluar për shkak të moskoordinimit të specifikacioneve teknike me nevojat reale të ndërmarrjes, ku nuk janë përfshirë të gjitha kërkesat e nevojshme për realizimin e projektit. Këto kërkesa nuk mumd të rregullohen në këtë fazë për arsye se nuk mund të** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | përcaktohet efekti financiar i tyre! |
| 26 | 25_063 | Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran-Retender 2 | 06.08.2025 | 500.00 € | 07.08.2025 | 12.08.2025 | 424.80 € | OE "GJEO-PROJEKT" SH.P.K. | KONTRAKTUAR! |
| 27 | 25_069 | Furnizim me Kondenzator per SP Fushtice | 07.08.2025 | 900.00 € | 08.08.2025 | 13.08.2025 | 884.00 € | OE "Elektro SP" SH.P.K. | KONTRAKTUAR! |
| 28 | 25_068 | Zhvendosja Rivendosja e inventarit punues në faza të drejtorisë së Ibër-Lepencit | 18.08.2025 | 9,950.00 € | 25.08.2025 | 25.08.2025 | 9,944.00 € | OE "BABAJ COMPANY" SH.P.K. | KONTRAKTUAR! |
| 29 | 25_070 | Furnizimi dhe montimi i dy baterive për vetura dhe një bateri për gjeneratorë. | 18.08.2025 | 477.00 € | 19.08.2025 | 20.08.2025 | 450.99 € | OE "Auto-Albani" SH.P.K. | KONTRAKTUAR! |
| 30 | 25_072 | Sherbime të skanimit për IL-në. | 20.08.2025 | 990.00 € | 22.08.2025 | / | / | / | Anuluar, asnje oferte e pranuar! |
| 31 | 25_072 | Sherbime te skanimit per IL'ne - RITENDER | 27.08.2025 | 990.00 € | 29.08.2025 | / | / | / | Anuluar, asnje oferte e pranuar! |
| 32 | AQP | Furnizim me derivate per institucionet qendrore te RKS | Procedure e udhehequr nga AQP | 71,080.00 | Procedure e udhehequr nga AQP | 11.06.2025 | Sipas planifikimit! | OE "Petrol Company" | KONTRAKTUAR nga AQP |
| 33 | 25_073 | Furnizim me kuti magazinimi per bartje, ruajtje dhe transport | 21.08.2025 | 3,000.00 € | 27.08..2025 | 04.09.2025 | 2,222.53 € | OE "SMART OFFICE & PRINT" SH.P.K | KONTRAKTUAR! |
| 34 | 25_074 | Dizajnimi, prodhimi dhe montimi i 4 shtyllave metalike në HC UJMAN. | 04.09.2025 | 4,990.00 € | 10.09.2025 | 29.09.2025 | 4,222.87 € | OE "BMS SOLUTIONS" | KONTRAKTUAR! |
| 35 | 25_037 | Sanimi i gypit te demtuar te çelikut ne shtratin e lumit Iber - Ritender 3 | 08.09.2025 | 22,000.00 € | 29.09.2025 | / | / | / | KONTRAKTUAR! |
| 36 | 25_075 | Mirëmbajtja e permanente e LP 10kV dhe LP 35kV | 19.09.2025 | 7,000.00 € | 30.09.2025 | / | / | / | Anuluar, asnje oferte e pranuar! |
| 36 | 25_036 | Furnizim me paisje UAV për matje gjeodezike dhe pjeset tjera percjellse – RITENDER 1 | 06.08.2025 | 90,000.00 € | 27.08.2025 | 10.10.2025 | 59,919.74 € | OE: GJEO-PROJEKT SH.P.K. | KONTRAKTUAR! |
| 37 | 25_037 | Sanimi i gypit te demtuar te çelikut ne shtratin e lumit Iber - Ritender 3 | 08.09.2025 | 22,000.00 € | 29.09.2025 | 08.10.2025 | 19,511.30 € | OE: VALA SH.P.K. | KONTRAKTUAR! |
| 38 | | Remonti i pajisjeve hidroturbine të | | | | / | / | | Anuluar, sipas Nenit 62, |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 25_071 | agregatëve A dhe B në HC | 08.09.2025 | 100,000.00 € | 30.09.2025 | | | | paragrafi 1.1, LPP, aktiviteti anulohet, dhe do te ritenderohet me rregullimin e procedures, qe te sigurohemi qe te jemi ne pajtueshmeri me LPP, pasi qe 2 ofertave te pranuara iu mungon perfshirja e cmimit per njesi te e tere tabela.! |
| 39 | 25_044 | Furnizim me mjete mbrojtëse në punë – **RITENDER 2** | 01.10.2025 | 9,000.00 € | 08.10.2025 | / | / | / | Anuluar, asnje oferte e pranuar! |
| 40 | 25_075 | Mirëmbajtja e permanente e LP 10 kV dhe LP 35 kV - **Retender** | 02.10.2025 | 7,000.00 € | 08.10.2025 | 30.10.2025 | 6,685.88 ®€ | OE: PDT SOLUTION | **KONTRAKTUAR!** |
| 41 | 25_077 | Furnizim dhe instalim i sistemeve mbrojtese elektrike per statcione pompike dhe objekte ndarese. | 08.10.2025 | 8,500.00 € | 14.10.2025 | / | / | / | Anuluar, asnje oferte e pranuar! |
